<td>vendim apo plan masash të miratuar pas sezonit veror 2025 për forcimin e kapaciteteve të shërbimit zjarrfikës.</td>
<td></td>
<td>vazhdueshme drejtuar Doganes dhe Drejtorise se Pergjithshme te MZSh-së.<br><br>
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Loji I Automjetit</th><th>Marka</th><th></th></tr>
<tr><td>1</td><td>Auto-shkallë</td><td>Renault</td><td>A<br>R</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Automjet shpetimi</td><td>Daf</td><td>A<br>S</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Zjarrfikse autopompë</td><td>Renault</td><td>A<br>F</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Zjarrfikse autopompë</td><td>Renault</td><td>A<br>F</td></tr>
<tr><td>5</td><td>Zjarrfikse autopompë</td><td>Man</td><td>A<br>F</td></tr>
<tr><td>6</td><td>Zjarrfikse autopompë</td><td>Man</td><td>A<br>F</td></tr>
<tr><td>7</td><td>Pick-up me pompë</td><td>Mitsubishi</td><td>A</td></tr>
<tr><td>8</td><td>Autobot me pompë</td><td>Iveco</td><td>Pa</td></tr>
</table>
4. Numrin aktual të personelit zjarrfikës, si dhe numrin e punonjësve të rinj të rekrutuar nga Vera 2025 deri më sot.</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **-Përgjigjie**: Numri aktual i punonjësve pranë kësaj drejtorie për vitin 2025 deri më sot është 31. Gjatë kësaj periudhe është kryer rekuetimi i një punonjësi në rolin bazë në pozicioni zjarrfikës luftues-shpëtues.<br><br>5. Numrin e vendeve vakante dhe nevojën për personel sipas standardeve ligjore.<br><br>**-Përgjigjie:** Bazuar në organikogramën e drejtorisë së MZSH-së aktualisht ka 4 (katër) vende vakante te shpërndara sipasfunksioneve: 1-Shef Sektori i Ndërhyrjeve dhe shuarjes të zjarreve ( roli i mesëm).<br><br>2-Drejtues automjeti zjarrfikës (roli bazë).<br><br>3- Zjarrfikës luftues-shpëtues (roli bazë).<br><br>4-Sektori i Logjistikës (ekonomist/e)<br><br>6. Masat konkrete të ndërmarra pas sezonit veror 2025 për përmirësimin e shërbimit zjarrfikës (blerje pajisjesh, trajnime, investime infrastrukturore, etj.).<br><br>**-Përgjigjie:** Nga ana e drejtorisë nuk ka qënë e nevojshme për blerje pajisjesh.<br><br>7. Buxhetin e alokuar për shërbimin zjarrfikës për vitet 2024–2026, si dhe shpenzimet konkrete të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kryera për mjete, pajisje dhe personel.<br><br>**-Përgjigjie:** Për këtë pyetje drejtojuni drejtorisë Financës, Buxhetit dhe MFK-së, Bashkia Korçë.<br><br>8. Numrin e rasteve të ndërhyrjes gjatë vitit 2025 dhe 2026, si dhe kohën mesatare të reagimit.<br><br>**-Përgjigjie:** Për vitin 2025 janë kryer 270 ndërhyrje operacionale prej të cilave 208 raste ndërhyrje operacionale për shuarje zjarri në kategori të ndryshme objektesh dhe 62 raste për shpëtim kryesisht: shpëtim personi, në ndihmë te policisë dhe ofrim shërbimi ndaj qytetarëve. Për vitin 2026 deri më sot janë kryer 59 ndërhyrje operacionale prej të cilave 43 raste ndërhyrje operacionale për shuarje zjarri në kategori të ndryshme objektesh dhe 16 raste për shpëtim kryesisht: shpëtim personi, në ndihmë te policisë dhe ofrim shërbimi ndaj qytetarëve. Lidhur me kohën e reagimit ajo ndryshon nga distanca e objektit/aktivitetit ku shfaqet gjendja e emrgjencës dhe nga një analizë e hollësishme të të gjitha ndërhyrjeve të kryera rezulton se kuha e reagimit është nga 3 minuta deri në 28 minuta.9. Çdo akt administrativ, vendim apo plan masash të miratuar pas sezonit veror 2025 për forcimin e kapaciteteve të shërbimit zjarrfikës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **-Përgjigjie:** Për këtë periudhë janë hartuar plani i masave të MZSH-së për stinën e Dimrit 2025-2026 si dhe plani i masave për stinën e Verës 2026.<br><br>Sqarrim: Për çdo paqartësi si dhe për më tepër informacion kontaktoni :tel 0694112589 | | |
| 10. | 30.04.2026 | Kërkesë për informacion:<br><br>Në kuadër të një monitorimi mbi performancën e shërbimeve publike dhe infrastrukturës në territorin e Bashkisë Korçë, ju drejtohem me këtë kërkesë për informacion zyrtar.<br><br>Ju lutem të më vini në dispozicion të dhëna mbi investimet financiare të kryera nga Bashkia Korçë për rrjetin e kanaleve kulluese gjatë vitit kalendarik 2024-2025, nëse është e mundur, sipas projekteve përkatëse.<br><br>Gjithashtu, referuar raporteve publike të Bashkisë Korçë ku deklarohet se rrjeti kullues ka funksionuar në masën 100%, kërkoj një sqarim lidhur me situatën e krijuar më datë 7 | 11.05.2026 | Ju falënderojmë për interesimin tuaj ndaj menaxhimit të infrastrukturës kulluese në territorin e Bashkisë Korçë. Në vijim të kërkesës suaj me datë 30.04.2026, ju paraqesim informacionin e mëposhtëm:<br>1. **Shërbimet e kryera për mirëmbajtjen e rrjetit kullues gjatë viteve 2024–2025**<br><br>Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë, nëpërmjet sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, ka kryer në mënyrë sistematike inspektime dhe punime mirëmbajtjeje në të gjithë rrjetin kullues. Ndërhyrjet janë realizuar kryesisht me mjete të rënda (ekskavatorë,) dhe fuqi punëtore, duke synuar pastrimin e kanaleve, largimin e sedimenteve dhe mbeturinave.<br>Në vitin 2024 janë pastruar 80,307 metra linearë kanale kulluese.<br>Në vitin 2025 janë pastruar 64,350 metra linearë kanale kulluese.<br>Këto punime kanë kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e kapacitetit hidraulik të rrjetit kullues.<br>2. **Situata e përmbytjeve të datës 7 janar 2026** | E plotë | S'ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | janar 2026, kur në fshatin Shamoll dhe në disa zona të tjera të fushës së Korçës janë raportuar përmbytje. Në këtë kuadër, kërkoj informacion mbi faktorët që kanë ndikuar në këtë situatë dhe nëse është bërë një vlerësim teknik mbi funksionalitetin e sistemit kullues në këto zona. | | Deklarata se "rrjeti kullues ka funksionuar në masën 100%" i referohet performancës së përgjithshme të sistemit gjatë periudhës vjetore, bazuar në funksionimin normal në kushte hidrometeorologjike tipike.<br>Më datë 7 janar 2026, reshje të dendura me intensitet të lartë shkaktuan qëndrim të përkohshëm të ujit në një pjesë të tokave të fshatit Shamoll dhe disa zonave të ulëta të fushës së Korçës. Sasia e reshjeve në atë ngjarje ishte jashtëzakonisht e lartë për klimën e zonës sonë, duke çuar në tejmbushje të lumenjve Devoll dhe Dunavec. Si rezultat, ujërat e shiut nuk mundën të shkarkoheshin menjëherë nëpërmjet kolektorëve kryesorë dhe kanaleve të tyre përkatës, duke shkaktuar qëndrimin e ujit në sipërfaqe për një kohë të shkurtër.<br>Me pushimin e reshjeve, uji u largua normalisht nëpërmjet rrjetit kullues, gjë që tregon se infrastruktura kryesore ishte funksionale.<br>Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë situatë:<br>• Reshjet ekstreme me intensitet të lartë brenda një kohe të shkurtër.<br>• Ndërhyrjet e paligjshme nga ana e fermerëve (ndërtim urë-kalimesh me tombino ose materiale tjera jashtë parametrave teknike), të cilat pengojnë rrjedhën e lirë të ujit.<br>• Hedhja e mbeturinave lokale dhe fushore në kanale, përrenj dhe lumenj.<br>• Dëmtime lokale të argjinaturave për shkak të përdorimit intensiv të tokës | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bujqësore duke mbjellë pemë dhe bimë të ndryshme.<br>• Ndërtime informale afër ose mbi argjinaturat e infrastrukturës së kullimit.<br><br>Falë mirëmbajtjes të rregullt të rrjetit kullues të kryer në vazhdimësi, dëmet materiale në zonat e prekura ishin minimale.<br>3. **Masat e marra dhe perspektiva**<br><br>Në vijim të bashkëpunimeve institucionale me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë, është kryer pastrimi i përroit të Qatromit dhe lumit Dunavec me anë të mjeteve në pronësi të tyre (ekskavator krahëgjatë). Aktualisht është duke u punuar për sistemimin e kolektorit të Shamollit.<br>Bashkia Korçë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike po punojnë vazhdimisht për forcimin e infrastrukturës kulluese. Për një planifikim më të saktë të veprave të reja mbrojtëse, është e nevojshme kryerja e modelimeve hidraulike për prurjet me probabilitet tejkalimi të paktën 1% (Q1%), gjë që kërkon të dhëna historike të plota hidrometeorologjike, të cilat mungojë që prej vitit 1990. Rivendosja e monitorimit sistematik është parashikuar në kuadër të Planeve të Baseneve Lumore dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.<br>Njëkohësisht, Bashkia Korçë po thellon bashkëpunimin me fermerët dhe banorët për të parandaluar ndërhyrjet e paligjshme, në zbatim të | | |

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>Ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.<br>Jemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm ose vizitë në terren nëse e konsideroni të nevojshme.<br>Me respekt,</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>11.</td>
<td>11.05.2026</td>
<td>Kërkesë për informacion:<br><br>Në kuadër të përgatitjes së një raporti monitorimi mbi gjendjen e sektorit të kulturës në Shqipëri, ju<br><br>lutem të më vini në dispozicion, në format elektronik, informacionin dhe dokumentet si më poshtë, për<br><br>periudhën 2020–2025:<br><br>1. Buxheti vjetor i miratuar për kulturën dhe realizimi faktik i tij, të ndara sipas programeve<br><br>buxhetore dhe institucioneve përfituese.<br><br>2. Numri i aktiviteteve, festivaleve ose projekteve kulturore të organizuara ose të mbështetura</td>
<td>22.05.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 11.05.2026, sipas të dhënave të marra nga Qendra e Artit dhe Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kontroll Territorit. Ju bëjmë me dije se:<br><br>1. Buxheti vjetor i miratuar për kulturën dhe realizimi faktik i tij, të ndara sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përfituese.<br><br>Buxheti vjetor i miratuar per kulturen. QAK Korce ka nje program AF122.<br><br>
<table>
<tr><th>Viti</th><th>2020</th><th>2021</th><th>2022</th></tr>
<tr><td>Plan</td><td>80.933.943</td><td>80.964.151</td><td>87.256.31</td></tr>
<tr><td>Fakt</td><td>56.909.618</td><td>65.336.174</td><td>74.513.09</td></tr>
</table>
</td>
<td>E plotë</td>
<td>S’ka tarifë</td>
</tr>
</table>

financiarisht nga bashkia për çdo vit gjatë periudhës 2020–2025.

3. Të dhëna mbi fondet publike të shpërndara në fushën e kulturës, duke specifikuar për çdo vit:

o numrin total të përfituesve;

o vlerën totale të fondeve të shpërndara;

o ndarjen sipas kategorive të aktiviteteve të mbështetura.

4. Lista e institucioneve kulturore në varësi të bashkisë, duke specifikuar:

o funksionin;

o vendndodhjen;

o numrin e punonjësve.

5. Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për çdo vit

2. Numri i aktiviteteve, festivaleve ose projekteve kulturore të organizuara ose të mbështetura financiarisht nga bashkia për çdo vit gjatë periudhës 2020–2025.

Numri i projekteve

| **Viti** | **2022** | **2021** | **2022** |
|---|---|---|---|
| **Plan** | 55 | 37 | 46 |
| **Fakt i rishikuar (pandemia )** | 27 | 35 | 45 |

3. Të dhëna mbi fondet publike të shpërndara në fushën e kulturës, duke specifikuar për çdo vit: numrin total të përfituesve, vlerën totale të fondeve të shpërndara, ndarjen sipas kategorive të aktiviteteve të mbështetura.

Fondet të ndara në fushën e kulturës

| | **2020** | | **2021** | | **2022** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Plan | fakt | Plan | fakt | Plan | fakt |
| Qendra kulturore | 38 | 18 | 24 | 22 | 32 | 31 |
| Biblioteka | 5 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 |

gjatë periudhës 2020–2025.

6. Informacion mbi fondet e përdorura për restaurime, rehabilitime ose ndërhyrje në objekte të

trashëgimisë kulturore, duke specifikuar:

o objektin;

o llojin e ndërhyrjes;

o vitin e realizimit;

o vlerën e financimit.

7. Lista e strategjive, planeve lokale ose dokumenteve politikë në fushën e kulturës të hartuara ose

zbatuara gjatë periudhës 2020–2025.

8. Numri i konsultimeve publike të zhvilluara në lidhje me kulturën, trashëgiminë kulturore ose

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Teatri | 12 | 7 | 10 | 10 | 11 | 11 | 11 | 11 | [illegible] |
| **Shuma** | **55** | **27** | **37** | **35** | **46** | **45** | **43** | **41** | [illegible] |
| | **Vlera e fondeve te shperndara plan- fakt** | | | | | | | | |
| QAK | 17410 | 9701 | 22757 | 22306 | 28425 | 27618 | 28697 | 19554 | [illegible] |
| | | | | | | | | | |

4. Lista e institucioneve kulturore në varësi të bashkisë, duke specifikuar: funksionin, vendndodhjen, numrin e punonjësve.

Qendra e Artit dhe Kulturës ( QAK) është institucion në varësi të Bashkisë Korçë, përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e jetës kulturore në qytet.
Qendra e Artit dhe Kulturës Korçë zbaton strategjinë kulturore të Bashkisë si dhe në raste të caktuara atë të Ministrisë së Kulturës për planin vjetor të aktiviteteve.Ky institucion në bashkëpunim me Bashkinë, siguron kushte për ruajtjen, vlerësimin dhe propagandimin e pasurisë kulturore të qytetit, nxit dhe stimulon vlerat e kulturës lokale, si dhe traditen kulturore historike. Qendra e Artit dhe Kulturës popullarizon në forma të ndryshme veprimtaritë intelektuale të qytetit, figurat e artit dhe kulturës, traditën historike dhe krijon mundësi për aftësimin e talenteve të reja në fusha të ndryshme të artit, kulturës, historisë e traditave popullore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aktivitetet kulturore gjatë periudhës 2020–2025.<br><br>9. Të dhëna mbi hapësirat publike ose infrastrukturën e përdorur për aktivitete kulturore gjatë<br><br>periudhës 2020–2025.<br><br>10. Nëse ekzistojnë, të dhëna mbi të ardhurat e gjeneruara nga institucionet kulturore në varësi të<br><br>bashkisë gjatë periudhës 2020–2025.<br><br>11. Në rast se bashkia disponon strategji, plane veprimi ose projekte në proces për zhvillimin e<br><br>kulturës, industrive kreative ose trashëgimisë kulturore për periudhën në vijim, ju lutem vini në<br><br>dispozicion informacion mbi statusin aktual të tyre.<br><br>12. Ju lutem specifikoni të dhëna mbi shpërndarjen e | | Qendra e Artit dhe Kulturës përfshin në juridiksionin e saj:<br><br>Qendrën Kulturore "Vangjush Mio", Muzeun "Bratko", Muzeun "Gjon Mili", Galerinë e Arteve "Guri Madhi", Galerinë e Artit Digjital, Teatrin "Andon Zako Çajupi", Bibliotekën "Thimi Mitko", si dhe Bibliotekë e fëmijëve "Thoma Turtulli".<br><br>Kjo qendër ka në strukturën e saj organizative 57 punonjës (plan) të miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Korçë si dhe urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë, të ndarë si më poshtë :<br><br>-Drejtor i përgjithshëm 1<br>-Qendra kulturore "V.Mio" 19<br>-Teatri "A.Z Cajupi" 25<br>-Biblioteka " Thimi Mitko" 12<br><br>5. Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për çdo vit gjatë periudhës 2020–2025.<br><br>Në administratën e Bashkisë Korçë, nuk ka një strukturë përgjegjëse për kulturën pasi ky funksion kryhet nga Qendra e Artit dhe Kulturës, njësi e varësisë së Bashkisë Korçë. | | |

aktiviteteve, investimeve ose infrastrukturës

kulturore sipas njësive administrative të bashkisë gjatë periudhës 2020–2025

| Viti | Numri i punonjësve (Plan ) | Numri i punonjësve (Fakt) |
|---|---|---|
| **2020** | 50 | 47 |
| **2021** | 50 | 47 |
| **2022** | 50 | 47 |
| **2023** | 50 | 45 |
| **2024** | 51 | 49 |
| **2025** | 54 | 50 |

6. Informacion mbi fondet e përdorura për restaurime, rehabilitime ose ndërhyrje në objekte të trashëgimisë kulturore, duke specifikuar: objektin, llojin e ndërhyrjes, vitin e realizimit, vlerën e financimit.

Për këtë pikë, duhet t'i drejtoheni Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë.

9. Të dhëna mbi hapësirat publike ose infrastrukturën e përdorur për aktivitete kulturore gjatë periudhës 2020–2025.

Gjatë periudhës 2020–2021 nuk janë realizuar aktivitete, si pasojë e kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë COVID-19. Në vijim, për periudhën 2022–2026, janë dhënë në total leje për 44 ditë, që zënë një sipërfaqe prej 141 m².

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për sa i takon pikave të tjera që lidhen me Qëndrën e Artit dhe Kultures (sipas stafit te QAK), i nevojitet me teper kohe ne dispozicion per te mbledhur matrjalin e nevojshem. Nese nuk keni kohe, ju lutemi të paraqiteni fizikisht pranë Qëndrës së Artit dhe Kulturës, ose te shikoni informacionin e pasqyruar ne web faqet perkatese. | | |
| 12. | 09.06.2026 | Kërkesë për informacion:<br><br>1. Ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup mosha 15-29 vjeç) për periudhën janar–dhjetor 2025? Nëse po, sa ishte ky buxhet për rininë dhe sa përbënte ai kundrejt buxhetit të bashkisë në total?<br>2. Ka përfituar bashkia nga projekte të financuara nga donatorë që synojnë rininë gjatë vitit 2025?<br>3. Ka buxhet të veçantë për Programe të Bashkisë për të rinjtë (15–29 vjeç)?<br>4. Sa është numri i të rinjve (18–29 vjeç) në bashki dhe sa prej tyre janë femra?<br>5. Sa është numri i të rinjve (18–29 vjeç) në bashki të kategorisë NEET? | | Pyetja 1<br>Bashkia ka pasur një buxhet të planifikuar për rininë gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025. Qendra Rinore, si strukturë e re për mbështetjen dhe angazhimin e të rinjve, ka pasur një buxhet të dedikuar për aktivitete rinore, programe edukative, kulturore, sociale dhe aktivitete të tjera që synojnë fuqizimin e të rinjve. Buxheti për rininë nuk buxhetohet më vete, por përcaktohet në bazë të programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese të Bashkisë Korçë (arsimi bazë, arsimi i mesëm i përgjithshëm, arsimi profesional, sport dhe argëtim). Buxheti i planifikuar për Qendrën Rinore për vitin 2025 është rreth 750.000 lekë.<br>Pyetja 3<br>Numri i punonjësve të Bashkisë Korçë për vitin 2025 është 291 punonjës , nga të cilët 133 femra dhe 158 meshkuj, asnjë me aftësi të kufizuar.<br>Pyetja 4<br>Numri i të rinjve të moshës (18-29) të punësuar në Bashkinë Korçë është 56 , nga të cilët 29 meshkuj dhe 27 femra, asnjë me aftësi të kufizuar.<br>Pyetja 5 | E plotë | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6. A ka bashkia politikë rinore të zhvilluar specifikisht për grupmoshën 15–29 vjeç?<br>7. A keni në institucion plane, strategji ose dokumente për rininë?<br>8. A ka struktura rinore në qeverisjen e bashkisë?<br>9. Me kë bashkëpunon për çështjet e strukturave rinore?<br>10. A keni një Plan Vendor Veprimi për Rininë ose dokumente të tjera për rininë?<br>11. Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor (KVR) në bashkinë tuaj.<br>12. Cilat janë mbështetjet dhe iniciativat që ka ndërmarrë bashkia për KVR?<br>13. A keni pasur të forma të tjera bashkëpunimi me grupe të rinjsh?<br>14. A organizon bashkia trajnime, qendra rinore ose aktivitete për të rinjtë?<br>15. A ofron bashkia mbështetje për programe rinore?<br>16. A keni një zyrë informacioni mbi aktivitetet për të rinjtë? | | Vetëm 3 meshkuj të grupmoshës 18-29 vjeç janë administratorë të 3 njësive administrative të Bashkisë Korçë. Të rinjtë e tjerë të punësuar pranë Bashkisë Korçë janë specialistë të kategorisë ekzekutive dhe punonjës me statuse të tjera (policë bashkiakë, logopedistë, psikologë, punonjës të parkimit me pagesë, inspektorë etj).<br>Pyetja 6<br>Bashkia ka hartuar dhe miratuar Planin Vendor të Rinisë, i cili adreson nevojat dhe prioritetet e grupmoshës 15–29 vjeç. Ky plan përfshin masa për fuqizimin e të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes në jetën publike, zhvillimin e aftësive, nxitjen e punësimit dhe promovimin e përfshirjes sociale.<br><br>Pyetja 7<br>Kabineti i Kryetarit të Bashkisë ka një këshilltar për çështjet e rinisë. Struktura e dedikuar për çështjet e rinisë është Qendra Rinore, funksionale që nga korriku 2025, me dy punonjës:<br> Përgjegjësin e Qendrës Rinore<br> Specialistin e rinisë<br><br>Pyetja 8<br>Në Bashki funksionojnë struktura rinore të dedikuara për grupmoshën 15–29 vjeç:<br> Qendra Rinore<br> Këshilli Vendor Rinor (KVR)<br>Këto struktura bashkëpunojnë për identifikimin e nevojave, organizimin e aktiviteteve dhe konsultimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse lokale.<br>Pyetja 9 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 17. Në çfarë mënyre janë të rinjtë të përfshirë në proceset vendimmarrëse?<br>18. Gjatë vitit 2025, sa konsultime publike me pjesëmarrjen e të rinjve ka organizuar bashkia?<br>19. Cilat janë fushat kryesore ku të rinjtë janë angazhuar në nivel vendor?<br>20. A keni bërë konsultime online me të rinjtë?<br>21. A ofron bashkia mbështetje për sipërmarrjen rinore?<br>22. A keni iniciativa të reja ose historik suksesi në mbështetjen e të rinjve?<br>23. A ka masa ose programe specifike për grupet vulnerabël të të rinjve?<br>24. Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024?<br>25. Sa është numri i të rinjve (15–29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024?<br>26. Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? | | Për ngritjen e strukturave rinore, Bashkia ka bashkëpunuar me organizata rinore dhe individë aktivë. Ndër partnerët kryesorë:<br> World Vision<br> Balkan Youth Activities<br> Dorcas Albania<br> Federata e Familjes<br>Pyetja 10<br>Bashkia disponon një Plan Vendor të Veprimit për Rininë, i cili adreson çështjet kryesore të të rinjve. Dokumenti bashkëngjitet për referencë dhe konsultim.<br>Pyetja 11<br> Këshilli Vendor Rinor (KVR) është krijuar në vitin 2022<br> Numri i anëtarëve: 10<br> Numri i të rinjve të përfshirë: 5 (4 femra, 1 mashkull)<br> Numri i mbledhjeve gjatë vitit 2025: 3<br> Numri i aktiviteteve të organizuara: 3<br><br>Pyetja 12<br>Përmirësimi i funksionimit të KVR kërkon:<br> Trajnime dhe shkëmbim përvojash për anëtarët<br> Mbështetje financiare për iniciativat rinore<br><br> Forcim të bashkëpunimit me organizata rinore, institucione arsimore dhe partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë<br>Pyetja 13<br>Ka pasur bashkëpunime me grupe rinore dhe organizata për aktivitete kulturore, sociale dhe ndërgjegjësuese. Partnerë kryesorë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 27. Sa është numri i të rinjve (15–29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024?<br>28. Sa është numri total i përfituesve që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024?<br>29. Sa është numri i të rinjve (15–29 vjeç) që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? | | □ Balkan Youth Activism<br>□ Dorcas Albania<br>□ Grupi rinorë lokalë aktivë<br>Pyetja 15<br>Bashkia ofron mbështetje për organizatat rinore në forma të ndryshme:<br>□ Vënien në dispozicion të ambienteve publike<br>□ Lehtësimin e bashkëpunimit institucional<br>□ Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe punëtorive<br>Pyetja 16<br>Gjatë vitit 2025 janë organizuar aktivitete kulturore, sportive dhe profesionale për të rinjtë.<br>Shembuj:<br>□ Klube vullnetare<br>□ Klube libri<br>□ Nisma komunitare dhe mjedisore<br>Pyetja 17<br>Të rinjtë përfshihen në vendimmarrje përmes:<br>□ Qendrës Rinore<br>□ Procesit të buxhetimit me pjesëmarrje<br>□ Konsultimeve publike<br>□ Këshillit Vendor Rinor<br>Pyetja 19<br>Sfidat kryesore:<br>□ Pjesëmarrje e kufizuar dhe jo e vazhdueshme e të rinjve<br>□ Nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përfshirjes<br>□ Kufizime në burime njerëzore dhe financiare<br><br>Pyetja 20 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Bashkia përdor platforma digjitale për komunikim me të rinjtë:<br> Faqja zyrtare e internetit<br> Rrjetet sociale (Facebook, Instagram)<br>Pyetja 21<br>Janë ofruar trajnime profesionale për të rinjtë në bashkëpunim me organizata partnere dhe inkubatorë biznesi, me qëllim rritjen e aftësive dhe mundësive për punësim.<br>Pyetja 22<br>Nisma me ndikim pozitiv:<br> Hackathon-e për zhvillimin e aftësive digjitale<br> Kampet verore të ICT Club<br> Shkëmbime rinore me organizata europiane<br><br>Pyetja 24<br>Numri i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike është 731 familje<br>Nga këto femra 207<br><br>Pyetja 25<br>Numrin e të rinjve përfitues të Skemës së Ndihmës Ekonomike (15-29) nuk e<br>disponojmë.<br>Pyetja 26<br>Numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe kujdestarëve të<br>tyre është 2238, nga këto 994 femra.<br>Pyetja 27<br>Numri i përfituesve të aftësisë së kufizuar është:<br>0-3 vjeç është 8 përfitues<br>4-18 vjeç është 337 përfitues | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 19-21 vjeç është 342 përfitues<br>22-60 vjeç është 734 përfitues<br>Mbi 60 vjeç është 817 përfitues<br>Pyetja 28<br>Numri total i personave të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror,<br>është rreth 700 përfitues.<br>Pyetja 29<br>Numri i të rinjve (15-29 vjec) pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror është 120 | | |
| 13. | 21.06.2026 | Kërkesë për informacion:<br><br>1. Politika Bashkiake dhe Përgjegjësia Institucionale<br><br>1.1 A ka bashkia ndonjë vendim, rregullore apo plan zyrtar për mirëqenien e kafshëve dhe menaxhimin e kafshëve endacake? Ju lutemi bash këngjitni dokumentet përkatëse.<br><br>1.2 Kur është përditësuar për herë të fundit ky dokument apo kjo praktikë?<br><br>1.3 Cila strukturë në bashki është aktualisht përgjegjëse për këto çështje? | 02.07.2026 | Në përgjigje të kërkeses suaj, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korcë, ju ben me dije se:<br><br>Në territorin e Bashkisë Korçë ndodhet një strehë për strehimin e kafshëve të braktisura me një kapacitet prej 25 qen dhe një sipërfaqe prej 50 $m^2$.<br>Për vitin 2023 janë kapur, matrikulluar dhe sterilizuar 156 qen.<br>Gjatë vitit 2024 proçedura nuk është realizuar për arsye të anullimit të saj sepse nuk janë paraqitur operatorë ofertues.<br>Për këtë arsye për vitin 2025 NSHP Korçë vendosi ta realizojë vetë si shërbim duke blerë produkte dhe medikamente për proceduren e sterilizimit dhe matrikullimit të qenve endacake, produkte dhe medikamente për përdorimin e pushkës për kapjen e qenve endacake, ushqim për qentë dhe shërbimin e sterilizimit, pasi nuk kemi personel te kualifikuar.<br>Gjatë vitit 2025 e në vazhim në vitin 2026 janë kapur 55 qen endacakë në lagje të ndryshme të qytetit. Një pjesë e tyre janë lëshuar pasi kanë pasur | E plotë | S’ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Shërbimet Veterinare dhe Aksesueshmëria<br><br>4.1 A ka shërbim veterinar të kontraktuar apo të mbështetur nga bashkia?<br><br>2. Censusi, Infrastruktura dhe Shërbimet e Strehimit<br><br>2.1 A ka bashkia census ose vlerësim të numrit të qenve dhe maceve endacake në territorin e saj?<br><br>2.2 A keni informacion mbi numrin e kafshëve në pronësi të qytetarëve?<br><br>2.3 A ka bashkia në pronësi ose nën menaxhim një ose më shumë strehë kafshësh? Nëse po, ju lutemi specifikoni: nr. e strehave, adresën, vitet në funksion, numrin dhe pozicionet e punësve, kapacitetin strehues, shërbimet (kujdes mjekësor, sterilizim, birësim), buxhetin vjetor, bashkëpunimin me OJQ dhe aksesueshmërinë nga publiku.<br>3. Programet e Kontrollit të Kafshëve Endacake 3.1 A | | pronarë të cilët kanë ardhur i kanë kërkuar tek streha.<br>Pas sterilizimit ose kastrimit janë adoptuar nga qytetarë të ndyshëm 8 qen.<br>10 të tjerë pasi janë sterilizuar dhe kastruar, janë lëshuar me kërkesë të qytetarëve tek lagjet përkatëse ku janë kapur pasi janë qytetarët të cilët kujdesen për ushqimin dhe mirëmbajtjen e tyre.<br>Gjatë vizitavë të kryera janë konstatuar 25 qen me çrregullime neurologjike të shoqëruara me agresion patologjik si dhe me diagnoza të tjera dhe fraktura të shumëfishta me pasojë vuajtjen dhe lëngimin e tyre për një kohë të gjatë. Në bazë të ligjit Nr. 10006, dt. 23.10.2008 “Për mbrojtjen e shëndetit publik të cilat mbështeten tek parimi “Salus populi suprema lex”, këto kafshë janë vlerësuar si të rrezikshme për komunitetin dhe i janë nënshtruar euthanasisë dhe asgjësimit sipas rregullave të shërbimit veterinar me preparat T61.<br>Aktualisht në strehë mirëmbahen dhe u ofrohet shërbim 17 qenve. Paralelisht vijon proçesi i evidentimit dhe monitorimit të qenve endacakë në territorin e Bashkisë Korçë, me qëllim identifikim dhe trajtimin e tyre sipas proçedurave përkatëse<br>Ju falenderojmë për mirëkuptimin! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zbaton apo financon bashkia programe sterilizimi, vaksinimi apo kapjeje për kafshët endacake?<br><br>3.2 Ju lutemi jepni të dhëna vjetore për 4 vitet e fundit (2022–2025): numrin e kafshëve të sterilizuara, vaksinuara ose të kapura.<br><br>3.3 Programet ofrohen vetëm nga bashkia apo në bashkëpunim? Nëse bashkëpunoni, me cilët?<br><br>1 4.2 A ofrohen shërbime emergjente për kafshët endacake?<br><br>4.3 A ka klinika të lëvizshme apo shërbime për zonat rurale? Ju lutemi rendisni shërbimet dhe partnerët e përfshirë.<br><br>5. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik<br><br>5.1 A ka mbështetur apo organizuar bashkia fushata publike mbi mirëqenien e kafshëve, sterilizimin, birësimin apo ndërgjegjësimin kundër | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mizorisë në 4 vitet e fundit (2022–2025)? Nëse po, rendisni secilën dhe vitin.<br><br>5.2 A ka programe aktive në shkolla apo qendra komunitare? 6. Buxheti dhe Financimi 6.1 A ka bashkia linjë buxhetore të dedikuar për mirëqenien e kafshëve?<br><br>6.2 Nëse po, cilat shuma janë alokuar në 4 vitet e fundit (2022–2025)?<br><br>6.3 A ka përfituar bashkia fonde nga donorë, programe shtetërore apo OJQ? Nëse po, rendisni burimet. Me respekt, Oli Pero, Drejtore Ekzekutive, Animals Need Me<br><br>7. Mekanizmat e Ankesave dhe Raportimit<br><br>7.1 A ekziston kanal zyrtar (telefon, email, platformë dixhitale) për raportimin e problemeve me kafshët endacake apo rasteve të keqtrajtimit? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7.2 Sa ankesa janë regjistruar në 4 vitet e fundit (2022–2025) dhe çfarë veprimesh janë ndërmarrë?<br><br>7.3 A keni pasur raporte nga turistë ose qytetarë të huaj për probleme me kafshët endacake?<br>8. Stafi dhe Mbikëqyrja<br><br>8.1 A ka bashkia inspektorë, oficerë apo staf të dedikuar për monitorimin e mirëqenies së kafshëve?<br><br>8.2 Nëse po, sa persona janë të caktuar dhe në cilën strukturë? Ju lutemi bashkëngjitni dokumente, tabela, raporte apo vendime përkatëse. Nëse të dhënat nuk janë të disponueshme, ju lutemi specifikoni arsyen. Gjithashtu, ju lutemi jepni emrin, numrin e kontaktit dhe adresën e emailit të punësuesit përgjegjës për menaxhimin e kafshëve endacake. | | | | |